



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr.6370/2020

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Ardian Ajvazi – anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.L, H.L, Q.L, H.L, N.L, Z.L, T. L, T. L, B.L, trashëgimtar të ndjerit H.L, nga fshati “.....”, Komuna e Suharekës, të cilët i përfaqëson me autorizim A.L, ndërkaq këtë të fundit e përfaqëson S.S, nga Suharekë, kundër të paditurës Kompania “.....”, KP, me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga G.N, avokat nga Prishtina, rr.”.....” nr., me objekt të padisë kompensimin e dëmit material, duke vendosur sipas ankesave të palëve ndërgjyqëse, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.611/19, të datës 20.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **28.04.2022**, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**APROVOHEN** si të themelta ankesa e paditësve A.L, H.L, Q.L, H.L, N.L, Z. L, T. L, T.L, B.L, trashëgimtar të ndjerit H.L, nga fshati “.....”, Komuna e Suharekës dhe ankesa e të paditurit B...-E.... KP, me seli në Prishtinë, **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë C.nr.611/19, të datës 20.10.2020 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.611/19, të datës 20.10.2020, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve A.L etj, nga fshati “.....”, Komuna e Suharekës. Në pikën II të dispozitivit ka detyruar të paditurën B....-E.... KP, me seli në Prishtinë, që të paditësve A.L, H.L, Q.L, H.L, N.L, Z.L, T.L, T. L, B.L, trashëgimtar të ndjerit H.L, nga fshati “.....”, Komuna e Suharekës, të ua kompensoi dëmin e shkaktuar në pjesën e ngastrave kadastrale P-02653-0 në vendin e quajtur”.....” në sipërfaqe prej 1747 m2 ZK ....., me rastin e ndërtimit të auto udhës Vërmicë-Merdare dhe atë shumën prej 7.161,62 euro, me kamatë prej 8 % nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit deri në pagesën

definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.150 euro, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm, ndërsa në pikën III të dispozitivit ka refuzuar si të pa bazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë mbi shumat e aprovuar.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, kanë paraqitur ankesë të dy palët ndërgjyqëse. Padiësi përmes të autorizuarit të tij është ankuar, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që ta aprovoj ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta prish në tërësi si jo ligjor, pa drejtë dhe joefektiv, ashtu që rasti të vendoset profesionalisht dhe meritorisht në Gjykatën e Apelit, ose të udhëzohet shkalla e parë në rigjykim të rastit sipas vërejtjeve dhe udhëzimeve të shkallës së dytë.

Ndërsa, pala e paditur ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktik si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, ndërsa ka kërkuar nga Gjykata e Apelit që ankesën si të tillë ta aprovoj, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj ashtu që të refuzoj si të pa bazuar kërkesëpadinë e padiësve.

Palët ndërgjyqëse nuk kanë parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

-Ankesa e padiësve dhe ankesa e të paditurës janë **të themelta**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se padiësit me padinë e parashtruar më datën 07.11.2017, kanë kërkuar që të detyrohet e paditura B....-E..... KP, me seli në Prishtinë, që në emër të dëmeve të shkaktuara në ngastrën kadastrale P-02653-0, në vendin e quajtur “.....”, në sipërfaqe prej 1747 m<sup>2</sup>, ZK ....., me rastin e ndërtimit të autoudhës Morinë-Merdare, të ua paguan shumën prej 63,000.00 € së bashku me shumën prej 1,204.50 € në emër të fitimit të humbur si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nën kërcënimin e përmbarrimit.

Duke vepruar sipas kësaj padie, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, pas administrimit dhe shqyrtimit të provave, si në vijim: shiqimin e vendit të kontestuar me ekspertet përkatës me ekspertet e gjeodezisë I.T dhe K.G datë 12.12.2019, ekspertët e bujqësisë dhe financave A.K dhe S.B datë 21.01.2020, (dhe prova të tjera si në shkresat e lëndës), në bazë të të cilave gjykata ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.611/2019 të datës 20.10.2020, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e padiësve.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, mes tjerash theksoi se në mbështetje të provave si më sipër, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe në bazë të nenit 8 të LPK-së vendosi që pjesërisht ta aprovoi kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar pasi që e pajtuara duke mos iu përmbajtur marrëveshjes së datës 28.08.2012, me veprimet e saja ka bërë tejkalimin e pëlqimit të dhënë nga paditësit A.L etj, pasi që paluajtshmërinë kontestuese e ka bërë të pa shfrytëzueshme duke e mbushur me material inert mbi sipërfaqen e rrugës gjë e cila është konstatuar edhe nga ekspertët e lëmive përkatëse. Vendimin lidhur me shpenzime e procedurës ka vendosur sipas nenit 452.4 të LPK-së. *(më gjerësisht sikurse në arsyetim të aktgjykimit)*

Pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit tani për tani nuk mund t'i pranoni si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me të meta thelbësore nga neni 182.2 pika n) të LPK-së, pasi që aktgjykimi i ankimuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyetimin e aktgjykimit. Gjithashtu arsyetimi i aktgjykimit është i pa argumentuar për faktet vendimtare, faktet vendimtare janë kundërtënëse midis asaj që në arsyet e aktgjykimit dhe përmbajtjes së provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Me rastin e shqyrtimit të aktgjykimit të atakuar, brenda kufijve të pretendimeve ankimore, si dhe sipas detyrës zyrtare (ex officio), në kuptim të nenit 194 të LPK-së, Gjykatës së Apelit i rezulton se dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së parë nuk janë të formuluar konform nenit 160 të LPK-së, që përcakton strukturën dhe përmbajtjen që duhet ta ketë një vendim gjyqësor për të qenë i drejtë dhe i ligjshëm. Në këtë kuptim, për shkak të paqartësive të shumta që hasen në të, që lidhen me disa nga rrethanat kyçe faktike e juridike që e karakterizojnë këtë kontest juridiko-civil, pamundësohet edhe përmbarimi i vendimit gjyqësor në fjalë.

Një tjetër problem thelbësor që evidentohet në këtë aktgjykim të atakuar, që theksohet edhe nga pala ankuese, e që sjellë tek prishja e aktgjykimit të atakuar, është çështja e legjitimitetit real aktiv të paditësit A.L në këtë rast. Legjitimitetin real aktiv mund ta ketë vetëm pala që për shkak të krijimit të raportit juridik me palën tjetër ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e ndonjë detyrimi, apo njohjen e ndonjë të drejte nga pala tjetër. Në lidhje me këtë, referuar shkresave të lëndës, rezulton se qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur, se paditësi A.L me asnjë provë nuk ka dëshmuar para gjykatës që është posedues dhe pronar faktik i pajtueshmërisë kontestuese, sikurse e cilëson gjykata e shkallës së parë në dispozitiv dhe arsyetim të aktgjykimit të atakuar. Në anën tjetër, rezulton se gjykata e shkallës së parë gjatë procedurës së zhvilluar gjyqësore nuk e ka sqaruar këtë fakt vendimtar në lidhje me legjitimitetin real aktiv të paditësit A.L, si dhe asnjëherë nuk ka ndërmarr veprimet adekuate procedurale, përmes të cilave do të kishte kërkuar sqarimet e nevojshme nga pala paditëse, në lidhje me provimin e faktit se e njëjti është posedues dhe pronar faktik i ngastrës kontestuese, për çka edhe eventualisht do të mund të legjitimohej si palë paditëse në këtë procedurë kontestimore. Kjo për

faktin se referuar shkresave të lëndës (ekspertizës së gjeodezisë dhe aktvdekjes për të ndjerin H. L), rezulton se në regjistrin kadastral si pronar i ngastrës kontestuese evidentohet tani i ndjeri H.L. Në anën tjetër, referuar këtyre provave rezulton se pasardhësit juridik dhe trashëgimtarët ligjor të këtij të fundit janë paditësit tjerë H.L, Q.L, H.L, N.L, Z.L, T.L, T.L, B.L, ndërsa procedura e trashëgimisë nuk ka përfunduar. Në lidhje me këtë, në mënyrën se si ka vendosur gjykata e shkallës së parë në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, të njëjtin e bënë plotësisht të paqartë dhe të pa përshtatshëm për përmbarrim. Kjo për faktin se detyrimi i të paditurës që të kompensojë dëmin në lartësinë e gjykuar në mënyrë solidare edhe poseduesit (*pronarit faktik siç është pretenduar*) edhe pronarëve juridik të cilët të drejtën e pronësisë mbi ngastrën kontestuese e kanë në bazë të trashëgimisë nga paraardhësi i tyre juridik, juridikisht nuk mund të qëndrojnë. Në rastin konkret, nuk mund të kenë legjitimitet të plotë aktiv në këtë çështje kontestimore në të njëjtën procedurë edhe poseduesi faktik (paditësi A.L), edhe paditësit tjerë-trashëgimtarët ligjor të ndjerit H.L, si dhe të kompensohen në mënyrë të barabartë në emër të kompensimit të dëmit të pretenduar. Andaj, gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të kësaj çështje kontestimore është dashur që paraprakisht të sqarojë dhe vërtetojë se kush në të vërtetë ka legjitimitet real aktiv në këtë kontest, poseduesi faktik (paditësi A.L), apo paditësit tjerë, për të cilët legjitimiteti aktiv rrjedh nga paraardhësi i tyre juridik, i cili në regjistrin kadastral evidentohet si pronar juridik i ngastrës kontestuese Nr.02653-0 ZK Bllacë. Qartësimi i kësaj çështje, pastaj do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë edhe në vendosjen meritorë të gjykatës, si dhe aktgjykimi do të ishte i qartë dhe i përmbarrueshëm.

Përveç të metave të evidentuara si më lartë, gjykatës së shkallës së dytë i rezultuan si të bazuara edhe pretendimet ankimore të palës së paditur, që kanë të bëjnë me vërtetimin e bazës juridike të kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material të shkaktuar në ngastrën kontestuese, si rezultat i hedhjes së zhavorit nga e paditura. Në lidhje me këtë, referuar shkresave të lëndës rezulton se paditësi A.L, përmes kërkesës së datës 28.08.2012, i është drejtuar këtu të paditurës që në ngastrën kontestuese të hedhet material nga gërmimet e bëra për ndërtimin e autostradës Morinë-Merdar, me kërkesë që toka të nivelohet deri në një lartësi të përafërt (sipas nevojës), siç paraqitet në prerjet tërthore të bashkangjitura. Në raport me këtë kërkesë, gjykatës së shkallës së dytë i rezultoi se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsytim të mjaftueshëm në arsytim të aktgjykimit, në lidhje me faktin se kërkesa në fjalë a është miratuar nga ana e të paditurës (mungon origjinali i saj, por edhe akti i të paditurës me të cilin është miratuar eventualisht kjo kërkesë e paditësit të parë), nëse po, a është respektuar në tërësi nga ana kjo e fundit. Në lidhje me këtë, rezulton se gjykata e shkallës së parë nuk ka zbatuar udhëzimet e dhëna nga gjykata e shkallës së dytë përmes aktvendimit Ac.nr.578/2015, datë 19.07.2019, për çka edhe ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të nenit 182.1, lidhur me nenin 199 të LPK-së. Mos sqarimi i çështjeve të cekura më lartë, ka pasur ndikim edhe në trajtimin e kësaj çështjeje, të pretenduar nga pala e paditur, konform dispozitës së nenit 145 të LMD-së, e cila shprehimisht thotë *"Kush në dëm të vet i lejon tjetrit ndërmarrjen e ndonjë veprimi, nuk mund të kërkojë prej tij shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga ky veprim"*, Edhe kjo përbën bazë të mjaftueshme procedurale për ta prishur aktgjykimin e atakuar.

Përveç të metave të evidentuara si më lartë, gjykatës së shkallës së dytë i kanë rezultuar si të bazuara edhe pretendimet ankimore të palës paditëse që kanë të bëjnë me vendosjen e gjykatës së shkallës së parë si dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, përkatësisht pikës III të dispozitivit, që ka të bëjë me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësve. Në këtë drejtim, rezulton se gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur në tërësi konform kërkesëpadisë së precizuar të palës paditëse, përmes parashtrësës së dorëzuar gjykatës, si dhe nuk është saktësuar se çfarë në të vërtetë është refuzuar nga kërkesëpadia e paditësve. Kjo për faktin se referuar pikës III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, nuk është e qartë se cila ka qenë pjesa e kërkesëpadisë së precizuar të paditësve, e cila është refuzuar nga gjykata e shkallës së parë. Në lidhje me këtë, gjykata nuk ka vepruar konform dispozitës ligjore të përcaktuar në nenin 160 parag.3, e cila shprehimisht thotë: *“Dispozitivi i aktgjykimit përmban: vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore, vendimin për ekzistimin apo mosekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë si dhe vendimin mbi shpenzimet procedurale”*. Andaj, në mënyrës se si e ka formuluar gjykata e shkallës së parë këtë pjesë të dispozitivit nuk është fare e qartë se çfarë në të vërtetë ka refuzuar, përkatësisht cila pjesë e kërkesëpadisë së paditësve është refuzuar, për çka edhe kjo ndikon pastaj edhe në çështjen se a konsiderohet kjo çështje e gjykuar (res judiciata), nëse eventualisht do të vërtetohej në aktgjykim i tillë. Përveç kësaj, gjykatës së shkallës së dytë i rezultoi se edhe pjesa arsyetuese e aktgjykimit të atakuar, nuk është hartuar në përputhje me dispozitën e nenit 160 parag.4 të LPK-së, e cila shprehimisht thotë: *“Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato”*. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm në lidhje me vërtetimin e fakteve vendimtare, të cilat ndërliken me bazën juridike të kërkesëpadisë, por edhe me lartësinë e saj. Në lidhje me këtë, në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë, gjatë marrjes së aktgjykimit të atakuar nuk ka dhënë fare arsyetim për mundësinë e zbatimit të dispozitës së nenit 169.1 të LMD-së: *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”*. Në bazë të kësaj dispozite obligohet personi i cili e ka shkaktuar dëmin që ta kthej në gjendjen e mëparshme nëse kjo është e mundur, ose në të kundërtën të bëjë kompensimin përkatës në para (169.2 dhe 169.3 të LMD-së).

Shkeljet e mësipërme të dispozitave imperative të procedurës kontestimore, përbëjnë shkelje esenciale ligjore, me rëndësi absolute, sipas nenit 182.1, lidhur me nenin 160 dhe nenit 182.2 pika n) të LPK-së. Shkelje të këtij karakteri, krijojnë prezumimin e menjëhershëm se vendimi gjyqësor i lëshuar, e që shqyrtohet nga Gjykata e Apelit, është i padrejtë dhe i paligjshëm, pavarësisht shqyrtimit të drejtë apo jo të anës materiale/substanciale të kontestit, që gjykata e shkallës së parë ka bërë. Për këtë arsye, meqë shkelje të tilla janë evidentuar duke pasur për bazë pretendimet ankimore të palës ankuese nga kjo Gjykatë e shkallës së dytë, atëherë aktgjykimi i atakuar është dashur të priset dhe lënda të rikthehet në rigjykim të shkallës së parë, në mënyrë që një aktgjykim i tillë të jetë i qartë.

Nga të gjitha të lartëcekurat, udhëzohet gjykata e shkallës së parë, që me rastin e marrjes së lëndës në rigjykim dhe rivendosje, të ndërmarrë veprime të caktuara për eliminimin e shkeljeve të përmendura, në pajtim me dispozitat imperative ligjore, duke u kujdesur njëkohësisht edhe për çështjet tjera nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor, më përkatësisht, të sqarojë qartë gjendjen e përgjithshme faktike, të sqarohet në mënyrë të saktë fakti se në emër të kujt evidentohen ngastrat kadastrale kontestuese, përkatësisht gjendja e tyre faktike e juridike në regjistrin kadastral, duke kërkuar plotësim të ekspertizës nga eksperti i gjeodezisë, si dhe gjithësesi, të shqyrtojë saktë çështjen e legjitimitetit të palëve në kontest, përkatësisht nga pala paditëse të kërkojë rregullimin e padisë, në atë mënyrë që qartësohet se kush janë palë paditëse të cilat e kanë legjitimitetin real aktiv në këtë çështje kontestimore dhe të njëjtat të përfshihen si palë në këtë çështje kontestimore. Pas vërtetimit të të gjitha fakteve dhe kryerjes së të gjitha veprimeve që i ka për obligim si gjykatë, e njëjta udhëzohet që të vendosë drejtë lidhur me rastin, duke i shqyrtuar dhe arsyetuar edhe të gjitha pretendimet e këtu të paditurës që kanë të bëjnë me kontestimin e bazës juridike të kërkesëpadisë dhe lartësisë së saj, çështjen e kërkesës së paditësit të parë drejtuar të paditurës për hedhjen e materialit përkatës në pjesën e ngastrës kontestuese, përkatësisht të sqarohet fakti se a është miratuar nga ana e të paditurës (*mungon origjinali i saj, por edhe akti i të paditurës me të cilin është miratuar eventualisht kjo kërkesë e paditësit të parë*), nëse po, të sqarohet fakti se a është respektuar në tërësi nga ana e të paditurës. Në fund udhëzohet gjykata e shkallës së parë që me rastin e përpilimit të aktgjykimit, t'i ketë parasysh kërkesat ligjore që rrjedhin nga dispozitat e nenit 160 të LPK-së (*aktgjykimi ti përmbaj të gjitha elementet e parapara me parag. 3, 4, 5 të këtij neni, përkatësisht të ketë dispozitiv të qartë, arsyetim të strukturuar mirë, përkatësisht të ketë një kronologji duke zbatuar me saktësi nenin 8 të LPK-së*), ashtu që pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, të vërtetoj gjendjen faktike, duke i vlerësuar edhe të gjitha pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse të cekura më lartë, si dhe duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm për këto pretendime dhe në fund të vendos për kërkesëpadinë e paditësve në bazë të ligjit, përfshirë këtu edhe për shpenzimet e procedurës, duke zbatuar edhe udhëzimet e dhëna nga gjykata e shkallës së dytë përmes aktvendimit Ac.nr.578/2015, datë19.07.2019.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195, paragrafi 1, pika (c), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.6370/2020, datë 28.04.2022**

**Kryetari i kolegjit,**  
**Lumni Sallauka**